



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"**

Senati

Ref. Nr.

Pejë: 23.09.2024

Në bazë të nenit 42, 47 dhe 48 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Senati i UHZ-së, në mbledhjen e mbajtur me dt. 23.09.2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Rregullorja për Vitin Sabatik dhe Mobilitetin e Jashtëm të Personelit të Universitetit "Haxhi Zeka".
- II. Pjesë përbërse e këtij vendimi është edhe Rregullorja për Vitin Sabatik dhe Mobilitetin e Jashtëm të Personelit të Universitetit "Haxhi Zeka".
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryesues i Senatit
Prof. Dr. Armand Krasniqi



Vendimi t'i dërgohet: Menaxhmentit të UHZ-së; u.d. Sekretarit të Përgjithshëm; Njësive Akadematike; Zyrës së IT; Arhivës.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"**

Senati

Ref. Nr.

Pejë, Dt. 23.09.2024

Në bazë të nenit 42, 45 dhe 48 të Statutit të Universitetit, si dhe kërkesës nr. 2277 datë 17.09.2024 të Parlamentit Studentor, Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë në mbledhjen e mbajtur më 23.09.2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Lejohet afati i Shtatorit II për vitin akademik 2023/2024 për paraqitjen e provimeve. Studentët kanë të drejtë t'i paraqesin dy provime cilat vlejné edhe për kusht.
- II. Paraqitja e provimeve bëhet nga data 30.09.2024 deri me 06.10.2024, kurse mbajtja e provimeve bëhet nga data 07.10.2024 deri me 12.10.2024.
- III. Vendosja e notave të afatit të Shtatorit II, bëhet deri me datë 19.10.2024. Obligohen dekanët e njësive akademike që t'i njoftojné të gjithë mësimdhënësit që pas datës së lartëcekur notat në SMU nuk mund të vendosen.
- IV. Ky vendim vlen për dy nivelet e studimeve bachelor dhe master në të gjitha njësitë akademike.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi t'i dërgohet:

- Menaxhmentit të UHZ-së;
- Dekanëve të njësive akademike;
- Sekretarëve të njësive akademike;
- Zyrtarëve për çështje studentore;
- Drejtorit për çështje studentore;
- Zyrës së IT;
- Arkivit të UHZ – së.



Kryesues i Senatit
Prof. Dr. Armand Krasniqi



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"**

Senati

Ref. Nr.

Pejë, Dt. 23.09.2024

Në bazë të nenit 42, 45,47 dhe 48 të Statutit të Universitetit, si dhe propozimeve të njësive akademike për regjistrimin e studentëve të rinj në vitin akademik 2024/2025, Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë në mbledhjen e mbajtur më 23.09.2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Për shpalljen e konkursit për pranimin e studentëve në nivelin master për vitin akademik 2024/2025

- I. Përcaktohen kriteret për pranimin e studentëve në nivelin master për vitin akademik 2024/2025.
- II. Konkursi shpallet prej datës 01.10.2024 deri më datë 15.10.2024, në të gjitha programet e studimit për nivelin master që janë të akredituara.
- III. Provimi pranues do të mbahet më datë 16.10.2024.
- IV. Përcaktimi i numrit të studentëve do të bëhet sipas propozimeve të njësive akademike dhe në përputhje me vendimet e Agjencisë së Kosovës për Akreditim, si dhe vendimin e MASHTI-it për lejimin e kuotave të studentëve.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi t'i dërgohet:

- Prorektorëve të UHZ-së;
- U.d. Sekretarit të Përgjithshëm;
- Dekanëve të Njësive Akademike;
- Drejtorit për çështje studentore;
- Zyrtarëve për çështje studentore;
- Zyrës së IT;
- Arkivit të UHZ – së.

kryesues i Senatit
Prof. Dr. Armand Krasniqi



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"**

Senati

Pejë, dt. 23.09.2024

Në bazë të nenit 42, 45 dhe 48 pika 1.24 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë dhe pas shqyrtimit të kërkesës së Parlamentit Studentor nr. 2277 datë 17.09.2024, Senati i UHZ-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 23.09.2024, nxjerr:

V E N D I M

- I. Studentët e nivelit bachelor dhe master të të gjitha njësive akademike të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, mund të regjistrojnë vitin vijues sipas përcaktimit të ECTS/kredive, si më poshtë:
 1. Vitin e dytë në momentin që akumulojnë 34 ECTS/ kredi
 2. Vitin e tretë në momentin që akumulojnë 30 ECTS/kredi
 3. Vitin e katërt në momentin që akumulojnë 24 ECTS/kredi.
- II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi t'i dërgohet:

- Prorektorëve të UHZ-së;
- U.d. Sekretarit të Përgjithshëm;
- Dekanëve të Njësive Akademike;
- Drejtorit për çështje studentore;
- Zyrtarëve për çështje studentore;
- Zyrës së IT;
- Arkivit të UHZ – së.



Kryesues i Senatit
Prof. Dr. Armand Krasniqi



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"**

Senati

Ref. Nr.

Pejë, Dt. 23.09.2024

Në bazë të nenit 42, 45, dhe 48 të Statutit të Universitetit, Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë dhe pas shqyrtimit të kërkesës nr. 2250 datë 16.09.2024, Senati i UHZ-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 23.09.2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa nr. 2151 datë 04.09.2024 e Prof. Asoc.Dr. Alberta Tahiri për përdorimin e logos së Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, për librin Universitar.
- II. Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

Arsyetim

Pas shqyrtimit të kërkesës së dorëzuar nga Prof.Asoc.Dr. Alberta Tahiri me nr. protokoli 2151 datë 04.09.2024 për lejimin e përdorimit të logos së Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, për botimin e librit me titull: " Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi " Senati e refuzoi këtë kërkesë për arsye se nuk janë ndjekur procedurat e përcaktuara në Rregulloren për Botime. Kjo rregullore përcakton qartë hapat dhe dokumentacionin që duhet të përmbushet për t'u dhënë leja për përdorimin e logos së institucionit në publikime, përfshirë dorëzimin e kërkesës paraprake dhe miratimin nga organet përkatëse. Në mungesë të përmbushjes së këtyre kërkesave dhe procedurave zyrtare, kërkesa nuk mund të miratohet në këtë fazë. Andaj, nga sa u tha lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Vendimi t'i dërgohet:

- Të lartëcekurës;
- Rektorit;
- Prorektorese për mësimdhënie, çështje studentore dhe kërkime shkencore;
- u. d Sekretares së Përgjithshme;
- Kryesuesit për Teknologji të Informacionit;
- Arkivit të UHZ – së.

Kryesues i Senatit
Prof. Dr. Armand Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. 2311	Nr. i faq / Br. str / H. i. pg 1	
Data / Datum / Date 23.09.2024		Pejë Poç

**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"**

Senati

Pejë, dt. 23.09.2024

Në bazë të nenit 42, 45 dhe 48 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Senati i UHZ-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 23.09.2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Themelohet komisioni për hartimin e draft Rregullore për Mobilitetin e Jashtëm të Studentëve të UHZ-së.
 1. Prof.Ass.Dr. Alma Shehu – kryesuese;
 2. Prodekanët për çështje mësimore dhe akademike të të gjitha njësive akademike – anëtar;
 3. Ardif Bobi – Student /anëtar.
- II. Komisioni është i obliguar që në afat prej 60 ditë kalendarike nga dita e pranimit të këtij vendimi të sjell draft rregulloren së bashku me një raport për takimet e mbajtura, Senatit të UHZ-së.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryesues i Senatit
Prof. Dr. Armond Krasniqi

Vendimi t'i dërgohet: Anëtarëve të komisionit; Zyrës së Rektorit; U.d. Sekretares së Përgjithshme; Zyrës së IT-së; Arkivës së Universitetit.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"**

Senati

Pejë, dt. 23.09.2024

Në bazë të nenit 42, 45, 47, 48 dhe 101 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, pas shqyrtimit të kërkesave të njësive akademike për regjistrimin e studentëve të nivelit bachelor 2024/25 gjegjësisht zëvendësimin e kuotave të rezervuara, zëvendësimi i kandidatëve që nuk kanë regjistruar vitin sipas afatit në konkurs, Senati i UHZ-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 23.09.2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Për zëvendësimin e kandidatëve që nuk kanë regjistruar vitin sipas afatit të paraparë në konkurs, nëpër të gjitha njësitë akademike për nivelin bachelor për vitin akademik 2024/25, me kandidatë të cilët janë në radhë dhe plotësojnë kushtet dhe kriteret e konkursit.
- II. Për zëvendësimin e kuotave të rezervuara nëpër të gjitha njësitë akademike për nivelin bachelor për vitin akademik 2024/25 me kandidatë të cilët janë në radhë dhe plotësojnë kushtet dhe kriteret e konkursit.
- III. Për programet që kanë konkurse aktive të pranimit të studentëve, pika I dhe II e këtij vendimi vlen pas përfundimit të procesit të konkursit dhe shqyrtimit të ankesave.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi t'i dërgohet:

- Prorektorëve të UHZ-së;
- U.d. Sekretarit të Përgjithshëm;
- Dekanëve të Njësive Akademike;
- Drejtorit për çështje studentore;
- Sekretarëve të Njësive Akademike;
- Zyrës së IT;
- Arkivit të UHZ – së.



Kryesuesi i Senatit
Prof. Dr. Armand Krasniqi

Adresa: Rr. "UÇK-së" 30000 Pejë

www.unhz.eu ; E-mail: info@unhz.eu ; Tel. : +381/39/423 270



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJE
REKTORATI		
Nr./Br. i-nto	2314	Nr. i faq./Br. str./N. s. pg 1
Data / Datum / Date	23.09.2024	Pejë / Pejë

**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"**

Rektor:

Prof. dr. Armand Krasniqi

Ref. Nr.

Pejë,

Në bazë të nenit 47 pika 1.3, nenit 169 dhe nenit 172 të Statutit të UHZ, Rregullores nr. 025/23 për Procedurat Vlerësuese dhe Përzgjedhëse Lidhur më Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik të Rregullt në UHZ dhe Rregullores nr. 2863/23 për plotësim ndryshimin e Rregullores nr. 025/23 për Procedurat Vlerësuese dhe Përzgjedhëse Lidhur më Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik të Rregullt në UHZ, Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbledhjen e mbajtur më 23.09.2024, nxjerrë këtë:

VENDIM

- I. **Prof. Asoc. Dr. Kolë Krasniqi**, rizgjedhet **Profesor i Asocuar** për lëndët: E Drejta Penale, E Drejta Penale Ndërkombëtare.
- II. Rizgjedhja është bërë në tërësi në pajtim me kushtet e parapara në Konkurs dhe sipas Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.
- III. I rizgjedhuri është i detyruar që t'u përmbahet në tërësi dispozitave të Statutit të Universitetit, si dhe të pranoj angazhimet e caktuara nga menaxhmenti i njësisë akademike për përmbajtjen e obligimeve të parapara me kontratë.
- IV. Emërimi zgjatë 4 (katër) vite.
- V. Çështja e pagesës së të ardhurave personale rregullohet sipas rregullores për të ardhurat personale dhe kontratës që Universiteti ia ofron të zgjedhurit.
- VI. Ky vendim hynë në fuqi më dt. 01.10.2024.

Arsyetim

Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, ka shpallur konkurs ref. nr. 244/24 dt. 02.02.2024, për riemërimin dhe avancimin e personelit akademik të rregullt në UHZ.

Sipas Rregullores nr. 025/23 për Procedurat Vlerësuese dhe Përzgjedhëse Lidhur me Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik të Rregullt të UHZ-së, dhe Rregullores nr. 2863/23 për plotësim ndryshimin e Rregullores nr. 025/23 për Procedurat Vlerësuese dhe Përzgjedhëse Lidhur më Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik të Rregullt në UHZ, Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbledhjen e mbajtur më dt. 23.09.2024, duke u bazuar në raportin e komisionit vlerësues, propozimin e këshillit të njësisë akademike dhe rekomandimin nr. 2292/24, të dt. 19.09.2024, të Komisionit të Studimeve në nivel të Senatit, vendosi që Prof. Asoc. Dr. Kolë Krasniqi, të rizgjedhet **Profesor i Asocuar** për lëndët e lartëcekura.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, është e lejuar ankesa, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditë, pas pranimit të vendimit, në komisionin për ankesa dhe parashtrës në kuadër të Senatit.



Rektor
Prof. Dr. Armand Krasniqi

Vendimi t'i dërgohet: Të rizgjedhurit, Rektorit, u. d Sekretares së Përgjithshme, Njësisë akademike – Fakultetit, Zyrës për çështje akademike, Menaxherit të personelit, Zyrës së financave, Kryesuesit për Teknologji të Informacionit, Arkivit të UHZ – së.